

URDHËR
Nr. 2/1, datë 8.1.2013

PËR HEQJEN E LICENCËS SË USHTRIMIT TË PROFESIONIT TË NOTERIT

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës, të nenit 7 pika 1 të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001 “Për organizmin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar, të shkronjës “a” të nenit 6 të ligjit nr. 7829, datë 1.6.1994 “Për noterinë”, të ndryshuar,

KONSTATOJ:

Nga verifikimi i regjistrit të përgjithshëm të noterëve, të administruar nga Ministria e Drejtësisë, rezulton se noterja znj.Natasha Thanas Stefa, e datëlindjes 2.1.1948, e pajisur me licencën nr. 5175, datë 17.10.2000, e cila ushtron verpimtarinë e saj noteriale pranë Bashkisë Kuçovë, ka mbushur moshën 65 vjeç.

PËR KËTO ARSYE,

Mbështetur në shkronjën b të nenit 6 të ligjit nr. 7829, datë 1.6.1994 “Për noterinë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Heqjen e licencës së ushtrimit të profesionit të noteres znj. Natasha Stefa, anëtare e Dhomës së Noterisë Vlorë, pasi ka mbushur moshën 65 vjeç.

2. Ngritjen e komisionit të dorëzimit të arkivit të përbërë nga 5 anëtarë:

a) Znj.Odeta Dervishi, inspektore në Drejtorinë e Inspektimit të Institucioneve të Varësisë dhe Profesioneve të Lira.

b) Znj.Rezarta Koçi, inspektore në Drejtorinë e Inspektimit të Institucioneve të Varësisë dhe Profesioneve të Lira.

c) Z.Erjon Ndreca, inspektor në Drejtorinë e Inspektimit të Institucioneve të Varësisë dhe Profesioneve të Lira.

d) Një përfaqësues i Dhomës Kombëtare të Noterisë.

e) Një përfaqësues i Dhomës së Noterisë Vlorë.

3. Arkivi do të merret në dorëzim me procesverbal në bashkëpunim me Dhomën e Noterisë Vlorë. Arkivi do t’i jepet në ruajtje dhe administrim, brenda një afati 3-mujor, noteres Anila Bardhi, e cila plotëson kushtet teknike për mirëmbajtjen e dokumenteve të arkivit dhe që kryen një shërbim sa më të shpejtë e cilësor të interesuarve, për lëshimin e kopjeve dhe shkurtimin e akteve.

4. Nxjerrjen jashtë përdorimit të vulave respektive, vulës së thatë dhe vulës së njomë, të noteres Natasha Stefa nga komisioni i caktuar në pikën 2 të këtij urdhri.

5. Urdhri t’i njoftohet menjëherë ministrive, Dhomës Kombëtare të Noterisë, gjykatave të Shkallës së Parë dhe Apelit, Gjykatës së Lartë, Gjykatës Kushtetuese, Prokurorisë së Përgjithshme dhe institucioneve në varësi të Ministrisë së Drejtësisë.

6. Ngarkohet Drejtoria e Inspektimit të Institucioneve të Varësisë dhe Profesioneve të Lira të marrë masat e nevojshme për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I DREJTËSISË
Eduard Halimi